

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: PAKR 1731/2012

Data: 22 gusht 2013

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarës së EULEX-it Annemarie Meister, kryetare e kolegjit dhe gjyqtare raportuese, si edhe gjyqtarit Tore Thomassen (EULEX) dhe Rasim Rasimi si anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e Andres Parmas, zyrtar ligjor i EULEX-it, i cili vepron si procesmbajtës, në procedurën penale kundër

A. A., i lindur më ..., në ...;

i cili u shpall fajtor dhe u dënua me aktgjykimin P. Nr. 130/2009 të datës 28 mars 2011 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë për veprën penale të Mashtrim në kundërshtim me nenin 261 (2) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPK) dhe ekuivalent me nenin 140 (1) dhe (2) të Ligjit penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës;

duke vepruar sipas ankesave në vijim kundër aktgjykimit P 130/2009 të ushtruara në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë:

- Ankesa e avokatit mbrojtës A.A. e ushtruar në emër të të pandehurit A. A. më 7 dhjetor 2012,
- Ankesa e avokatit mbrojtës V.G. e ushtruar në emër të të pandehurit A. A. më 7 dhjetor 2012,

pas leximit të përgjigjes së prokurorit të apelit të shtetit të Kosovës, Haxhi Derguti, nr. PPA 139/13 të datës 18 qershor 2013;

pas mbajtjes së seancës së hapur më 22 gusht 2013 në praninë e prokurorit të shtetit të apelit Sabri Ademi, të pandehurit dhe avokatit mbrojtës A.A.;

pas këshillimit dhe votimit më 22 gusht 2013,

në pajtueshmëri me nenet 112 (1) dhe (3); 389 4); 420 dhe 426 (1) të Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës (KPPPK)

AKTGJYKIM

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë i datës 28 mars 2011 ndryshohet me sa vijon:

- 1) Anulohet aktgjykimi përmes të cilit A. A. u shpall fajtor për veprën penale Mashtrim në kundërshtim me nenin 261 (2) të KPK-së, përmes të cilit u dënua dhe u obligua t'i kompensojë dëmin e shkaktuar D. H.;**
- 2) Refuzohet akuza me veprën penale të përmendur kundër të pandehurit A. A.;**
- 3) Ankesat pranohen pjesërisht;**
- 4) Përmes kësaj pala e dëmtuar D.H. udhëzohet që sipas nenit 112 (3) të KPPPK-së të ushtroj kërkesë pasurore juridike në kontest civil ndaj të pandehurit A. A. që ngrihet nga veprimtaritë që ishin çështje trajtimi në procedurën penale në fjalë.**

ARSYETIMI

I. Historia e procedurës së lëndës

1. Më 1 nëntor 2007 prokurori publik ngriti aktakuzën nr. PPS 385-10/2006 kundër A. A. i akuzuar për veprën penale të Mashtrim në kundërshtim me nenin 261 (1) dhe (2) të KPK-së.
2. Shqyrtimi gjyqësor në këtë lëndë penale u mbajt më 22 nëntor 2010 dhe 28 mars 2011 në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Më 28 mars 2011 trupi gjykues shpalli publikisht aktgjykimin Nr. 130/2009 me të cilin i pandehuri A. A. u shpall fajtor për veprën penale të Mashtrim sipas nenit 261 (2) të KPK-së, sepse më 20 janar 2003 ai mashtroi D. H. duke bërë rrejshëm të besoj se ne shkëmbim të 20 000 Euro të marra nga D. H. ai do të shfrytëzoj ndikimin e tij për të siguruar lirimin e menjëhershëm të N. H. nga burgu i Dubravës, që është i ati i palës së dëmtuar. Ai ishte i dënuar me 1 viti e 6 muaj burgim.

Sipas nenit 41 (1) 1); neneve 42 dhe 43; nenit 44 (1)-(3) dhe nenit 66 2) të KPK-dënimi ishte me kusht ashtu që A. A. të mos kryej ndonjë vepër tjetër penale brenda periudhës kohore prej 3 vjet dhe t'i kompensoj dëmin e shkaktuar palës së dëmtuar. A. A. ishte i obliguar që brenda 2 vjetësh t'i kompensoj dëmin e shkaktuar D. H. në shumën prej 20 000 Euro. Koha e kaluar në paraburgim është llogaritur në lartësinë e dënimit duke pasur parasysh se dënimi me kusht duhet të revokohet. A. A. u obligua të paguante shpenzimet e procedurës në shumën prej 100 Euro në emër të paushallit.

3. Avokati mbrojtës i të pandehurit A. A. rrjedhimisht ankimoi aktgjykimin. Shkresat e lëndës më pas u dërguan në Gjykatën Supreme të Kosovës si gjykatë kompetente e shkallës së dytë në atë kohë. Sipas nenit 39 paragrafi (1) i Ligjit mbi gjykatat, ligji nr. 03/L-199, më 1 janar 2013 lënda u transferua në Gjykatën e Apelit si gjykatë kompetente (e re) e apelit.

II. Parashtrësas e palëve

4. Më 7 dhjetor 2012 avokati mbrojtës A.A. ushtroi ankesë kundër aktgjykimit, duke kërkuar që i njëjti të priset dhe lënda të kthehet mbrapa në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim ose A. A. të lirohet. Ankuesi argumenton se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin e tij sepse faktet e paraqitura në arsyetim janë të paqarta dhe në kundërshtim me provat. Të dy elementet, ai objektiv edhe ai subjektiv, të krimit të Mashtrimit mungojnë në veprimet e të pandehurit. Gjykata nuk mori parasysh deklaratën e të pandehurit se në fakt ai pranoi para në shumën prej 20 000 Euro nga D. H., por jo me qëllim të lirimit të N. H. nga burgu. Paratë iu dhanë të pandehurit me qëllim të krijimit të fondeve për forcat e rezistencës në Maqedoni. Sipas avokatit mbrojtës, është e pabesueshme që një person me pozitë dhe autoritet si të të pandehurit, të kënaqej me veprime të tilla të ulëta për të mashtruar dikë me qëllim të përfitimit material.
5. Më 7 dhjetor 2012 edhe avokati tjetër mbrojtës i A. A., V.G. ushtroi ankesë kundër aktgjykimit. Ai kërkoi që aktgjykimi të anulohet dhe i pandehuri të lirohet. Ankuesi

argumenton se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, në kundërtënie me arsyetimin e tij dhe nuk ka radhitje ligjore të paraqitjes. Avokati mbrojtës vë në dukje se aktgjykimi së pari përmban veprën penale për të cilën A. A. u shpall fajtor, vetëm pastaj përmban dispozitivin dhe dënimin. Radhitja e drejtë do të ishte që fillimisht të konstatohet dispozitivi i veprës penale për të cilën i pandehuri u shpall fajtor, më pas formulimi ligjor i veprës penale dhe atëherë të përcaktohet dënimi. Pala ankuese gjen se argumentet në mbrojtje të të pandehurit në këtë aktgjykim kanë mbetur pa përgjigje të dhënë. Ekzistojnë prova se kjo lëndë ka natyrë politike dhe se është ndjekur vetëm me synimin e dëmtimit të partisë politike anëtar i të cilës është. Gjykata ka pranuar se i pandehuri nuk ka mund të ketë asnjë ndikim në lirimin e N. H. nga paraburgimi në procedurën penale dhe për këtë arsye gjykata nuk është dashur t'i mbështeste argumentet e saja në dëshmitë e marra nga N. H. dhe D. H.. Sqarimet e gjykatës lidhur me mosbesimin në argumentet në mbrojtje të A. A. t janë të palogjikshëm. Avokati mbrojtës po ashtu tërheq vërejtjen në faktin se i pandehuri nuk ka pasur mundësi gjatë procedurës penale për të kundërshtuar D. H. – dëshmitarin kyç kundër tij.

6. Më 19 qershor 2013, prokurori i apelit i shtetit ka dhënë përgjigjen ndaj ankesave duke propozuar refuzimin e tyre si të pabazuara. Prokurori gjen se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban asnjë shkelje esenciale të dispozitave të KPPK-së; dispozitivi i saj është i qartë dhe i kuptueshëm. Gjendja faktike në këtë lëndë është vërtetuar drejt nga ana e gjykatës si dhe aktgjykimi është arsyetuar mirë. Aktgjykimi nuk përmban asnjë shkelje të ligjit penal, siç pretendohet nga mbrojtja. Vendimi mbi dënimin është i saktë dhe i bazuar në mënyrë të mjaftueshme. Gjykata po ashtu ka vepruar drejt duke e obliguar të pandehurin për kompensim të palës së dëmtuar në vlerë prej 20 000 eurosh.
7. Në seancën e Gjykatës së Apelit më 22 gusht 2013, avokati mbrojtës A. A. ka kërkuar nga kolegji që t'i refuzojë akuzat ndaj të pandehurit me arsyetimin se krimi për të cilin është akuzuar, ka skaduar.

III. Kompetenca e Gjykatës së Apelit

8. Ankesat fillimisht i janë drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës në atë kohë gjykatë kompetente e shkallës së dytë. Megjithatë, sipas nenit 39 (1) të Ligjit mbi gjykatat, Ligjit nr. 03/L-199, më datën 21 janar 2013 kjo lëndë i është përcjellë Gjykatës së Apelit si gjykatë (e re) kompetente për ankesa.
9. Kolegji i Gjykatës së Apelit formohet në përputhje me nenin 19 (1) të Ligjit mbi gjykatat dhe me nenin 3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053). Në bazë të vendimit të Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it të datës 18 mars 2013, të marrë në pajtim me nenin 3.7 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, kolegji ka qenë i përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar kosovar i Gjykatës së Apelit.

IV. Ligji i zbatueshëm i procedurës

10. Ligji i procedurës penale i zbatueshëm në këtë lëndë specifike penale është Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, i cili ka qenë ligj në fuqi deri më datën 31 dhjetor 2012.¹ Interpretimi i drejtë i dispozitave kalimtare të Kodit të Procedurës Penale (KPP), i cili ka hyrë në fuqi nga data 1 janar 2013, parasheh që në procedurat penale të filluara para hyrjes në fuqi të kodit të ri, për të cilat gjykimi tashmë ka filluar por nuk ka përfunduar me marrjen e vendimit të formës së prerë, dispozitat e KPPK-së do të zbatohen *mutatis mutandis* derisa vendimi të marrë formën e prerë. Në këtë aspekt, i referohemi Mendimit juridik nr. 56 / 2013 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të miratuar në seancën e përgjithshme më datën 23 janar 2013.

V. Pranueshmëria e ankesës

11. Aktgjykimi i kundërshtuar është shpallur më 28 mars 2011. Aktgjykimi i shkruar i është dorëzuar të akuzuarit më 27 nëntor 2012. Ankesat e të dy avokatëve mbrojtës janë

¹Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale në Kosovë, i cili ka qenë në fuqi nga data 6 prill 2004 deri më 31 dhjetor 2012.

parashtruar më 7 dhjetor 2012. Gjykata e Apelit gjen se këto ankesa janë parashtruar nga personi i autorizuar dhe brenda afatit në pajtim me nenin 398 (1) dhe me nenin 399 (1) të KPPK-së.

VI. Gjetjet e Gjykatës së Apelit lidhur me meritat

12. Në lëndën në fjalë, A. A. është akuzuar për gjoja kryerjen e veprës penale të mashtrimit sipas nenit 261 (2) të KPK-së, që është e dënueshme me burgim deri në pesë vjet. Gjykata e Apelit vëren se sipas nenit 90 (1) 4) të KPK-së, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse nuk kanë kaluar pesë vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se 3 vjet por jo më shumë se 5 vjet. Sipas nenit 91 (1) afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon nga dita kur është kryer vepra penale. Edhe pse sipas par. (3) të të njëjtit nen afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim i cili ndërmerret për qëllime të ndjekjes penale të veprës penale të kryer, megjithatë në bazë të paragrafit (6) të të njëjtit nen ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit. Pasi që vepra penale për të cilën është akuzuar A. A. është kryer më shumë se 10 vjet e 7 muaj më parë, atëherë kemi të bëjmë me ndalesën absolute mbi ndjekjen penale për shkak se ka kaluar afati kohor të përcaktuar me nenin 90 (6) të KPK-së. Për këtë arsye, sipas nenit 389 1) të KPPK-së dhe nenit 426 (1) të KPPK-së, duhet të refuzohet akuza ndaj të pandehurit A. A.
13. Me aktgjykimin e kontestuar i pandehuri A. A. ka qenë i obliguar të kompensojë dëmin e shkaktuar ndaj palës së dëmtuar D. H. në shumën prej 20 000 Euro. Sipas nenit 112 (3) të KPPK-së, kur gjykata merr aktgjykim me të cilin refuzohet akuza, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest civil. Për këtë arsye duhet të anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut lidhur me vendimin e marrë në raport me kërkesën pasurore juridike.
14. Për arsyet në par. 12, nuk diskutohen argumentet mbi meritat dhe vendoset si në dispozitiv.

Përgatitur në gjuhën angleze, si gjuhë të autorizuar.

Kryetarja e kolegjit,

Annemarie Meister
Gjyqtare e EULEX-it

Anëtari i kolegjit

Tore Thomassen
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtari i kolegjit

Rasim Rasimi
Gjyqtar

Procesmbajtësi

Andres Parmas
Zyrtar ligjor i EULEX-it

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Pakr 1731 / 2012
22 gusht 2013